



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
REKTORATI

## Memorandum i bashkëpunimit

ndërmjet

Komisionit të Pavarur të Mediave

dhe

Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina"

Pranuar me dt. 8.1.2020			
Nj. org.	Numër	Nr.ekzempl.	Vlera
01	17		

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), me adresë rruga "Perandori Justinian" nr. 124, 10000 Prishtinë, përfaqësuar nga kryetari i KPM-së, z. Muja FERATI;

dhe

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me adresë rruga "Xhorxh Bush" nr. 31, 10000 Prishtinë, përfaqësuar nga rektori, prof. dr. Marjan Dema;

KPM-ja, si organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin nr. 1912/1457/KPM/mf të KPM-së të datës 30 dhjetor 2019;

Në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" do të përmbushë detyrimet si në vijim:

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi të bashkëpunimit është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) dhe Departamentit të Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës.

KPM-ja do të mundësojë zhvillimin e praktikës për studentët e Departamentit të Gazetarisë, të cilët janë në proces të studimit. Ky bashkëpunim do të mundësojë sigurimin e praktikës dhe rritjes profesionale të studentëve, të cilët, falë një formimi akademik më të zhvilluar, do të jenë më të përgatitur për tregun e punës. Studentët, të cilët e kryejnë praktikën, do t'i krijojnë vetës mundësi për të eksploruar fusha të ndryshme të karrierës që ata mund të ndjekin pas përfundimit të studimeve. Kjo praktikë do t'iu mundësojë organizatorëve vlerësimin e studentëve për punësimet e mëvonshme përmes marrjes së rekomandimeve, bazuar në rezultatet e tyre gjatë praktikës.



KPM-ja do të mundësojë shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe hapësirës së zyrës për hulumtime akademike të studentëve dhe stafit të Departamentit të Gazetarisë.

Palët nënshkruese të këtij memorandumi do të zhvillojnë aktivitete tjera që kanë të bëjnë me fushën e medias në përgjithësi.

## **Neni 2**

### **Format e bashkëpunimit**

1. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikës për studentët e Departamentit të Gazetarisë.
2. Përfaqësuesit e KPM-së, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të angazhohen në ligjërata për studentët e Departamentit të Gazetarisë. Ligjëratat do të jenë të karakterit jashtëkurrikular dhe do të organizohen në kuadër të aktiviteteve të departamentit, jashtë procesit mësimor.
3. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi për vizita studimore për studentët.
4. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi teknike për hulumtime akademike për studentët dhe stafin e këtij departamenti.
5. KPM-ja dhe Departamenti i Gazetarisë do të bashkëpunojnë në realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin medial.
6. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi për angazhim me pagesë të studentëve gjatë periudhave të fushatave zgjedhore.
7. KPM-ja dhe Departamenti i Gazetarisë do të bashkëpunojnë në aktiviteteve të ndryshme në fushën e medias në përgjithësi.
8. Të gjitha këto do të jenë në koordinim me organet e Universitetit të Prishtinës.

## **Neni 3**

### **Zhvillimi i praktikës në KPM**

1. Përzgjedhja e studentëve për praktikë në KPM bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga Departamenti i Gazetarisë.
2. KPM-ja do të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikës për studentët e përzgjedhur, të cilët i plotësojnë kriteret si më poshtë:
  - Të jenë në proces të kryerjes së studimeve pranë Departamentit të Gazetarisë;
  - Të mos kenë kryer më parë praktikë pranë KPM-së.

3. Kohëzgjatja e praktikës do të përcaktohet varësisht prej kërkesave dhe nevojave të Departamentit të Gazetarisë.
4. Dokumentacioni i kërkuar nga KPM-ja para fillimit të praktikës përfshin:
  - Curriculum Vitae;
  - Dëshmia e përzgjedhjes nga Departamenti i Gazetarisë;
  - Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
  - Një fotografi.
5. Gjatë kryerjes së praktikës në KPM, praktikantët janë të obliguar të:
  - Zhvillojnë aktivitetet e parapara në programin e praktikës, duke respektuar orarin e përcaktuar;
  - Ndjekin udhëzimet e përcaktuara nga personat përgjegjës;
  - Respektojnë rregullat e KPM-së, përfshirë ruajtjen e konfidencialitetit sa u përket të dhënave dhe informacioneve.
6. Studentët e përzgjedhur do të kryejnë praktikë pranë Departamenteve të Rregullatorit, përkatësisht: Departamentit Ligjor, Departamentit të Licencimit dhe Departamentit të Monitorimit dhe Analizave.
7. Gjatë kësaj periudhe, praktikantët, nën mbikëqyrjen e personave përgjegjës, do të përfshihet në këto procese:
  - 7.1 Njohja me aktet normative në fuqi, që përfshijnë rregullimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë: Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore të KPM-së.
  - 7.2 Njohja me procedurat e licencimit të KPM-së, përfshirë spektrin medial të të licencuarve nga KPM-ja.
  - 7.3 Angazhimi në aktivitete të monitorimit dhe analizave të përmbajtjeve programore të OSHMA-ve sipas akteve nënligjore të KPM-së.
8. Departamenti i Gazetarisë, në koordinim me KPM-në, mund të propozojë programe tjera për praktikë, varësisht nga nevojat dhe zhvillimet në aspektin medial dhe teknologjik.
9. Departamenti i Gazetarisë do të njoftojë paraprakisht KPM-në lidhur me planifikimin e kohës së mbajtjes së praktikës, duke përfshirë të dhënat rreth numrit të studentëve dhe temat që do të trajtohen.

#### **Neni 4**

#### **Angazhimi i përfaqësuesve të KPM-së në ligjërime**

1. Me ftesë nga Departamenti i Gazetarisë, sipas nevojës dhe planprogramit të tij, përfaqësuesit e KPM-së do të mbajnë ligjërata për studentët e këtij departamenti.

Ligjëratat do të jenë të karakterit jashtëkurrikular dhe do të organizohen në kuadër të aktiviteteve të departamentit, jashtë procesit mësimor.

2. Departamenti i Gazetarisë do të njoftojë paraprakisht KPM-në lidhur me planifikimin e orarit të ligjëratave, ku do të përfshihen përfaqësuesit e KPM-së, përfshirë këtu temat që do të trajtohen. Temat e trajtuara do të kenë ndërlidhje me fushën e ekspertizave të KPM-së dhe do të organizohen si diskutime jashtëkurrikulare.

#### **Neni 5**

##### **Vizitat studimore në KPM**

1. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi për grupe të studentëve për vizita studimore brenda ambienteve të punës së KPM-së, për t'u njohur me punën dhe aktivitetet e KPM-së.
2. Departamenti i Gazetarisë do të njoftojë paraprakisht KPM-në lidhur me planifikimin e orarit të vizitave studimore, përfshirë këtu temat që do të trajtohen.

#### **Neni 6**

##### **Ofrimi i kapaciteteve teknike për hulumtime akademike**

1. KPM-ja, në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, do të ofrojë mundësi për shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe hapësinore për hulumtime akademike për studentët dhe stafin e këtij departamenti.
2. Departamenti i Gazetarisë do të njoftojë paraprakisht KPM-në lidhur me orarin dhe kohën e planifikuar për hulumtime akademike, përfshirë informatat rreth personit/personave që do të marrin pjesë në hulumtime.

#### **Neni 7**

##### **Edukimi medial**

KPM-ja dhe Departamenti i Gazetarisë do të bashkëpunojnë në realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin medial, përfshirë organizimin e debateve, ligjëratave, trajnimeve dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me fushën përkatëse.

#### **Neni 8**

##### **Angazhimi me pagesë për studentë**

Varësisht nga nevojat dhe mundësitë financiare të KPM-së dhe në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, KPM-ja do të ofrojë mundësi për angazhim me pagesë të studentëve gjatë periudhave të fushatave zgjedhore në monitorimin e OSHMA-ve rreth pajtueshmërisë së tyre me Ligjin për Zgjedhje dhe legjislacionin e KPM-së.

**Neni 9**  
**Bashkëpunimet tjera**

KPM-ja dhe Departamenti i Gazetarisë do të bashkëpunojnë në aktiviteteve të ndryshme që ndërlidhen me fushën e medias në përgjithësi.

**Neni 10**

**Autorizimet**

Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm me qëllim zbatimin e pikave të këtij memorandumi palët caktojnë personat dhe pikat e kontaktit midis tyre si më poshtë:

Për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM): Zyra Ekzekutive e KPM-së

Tel: 038 245 031

Email: [info@kpm-ks.org](mailto:info@kpm-ks.org)

Për Universitetin e Prishtinës:

Qendra për Zhvillim të Karrierës e UP-së

Tel: +383 248 925

Email: [qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu)

**Neni 11**  
**Kohëzgjatja e bashkëpunimit**

Memorandumi i bashkëpunimit do të jetë në fuqi për një periudhë prej 08 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020, me mundësi vazhdimi.

**Neni 12**  
**Hyrja në fuqi**

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

